



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>DPKI</u>	Nr. Prot. <u>06-02/2689/22</u>
Nr. 1 faq. <u>02</u>	Data <u>08.06.2022</u>
Broj stranic <u>02</u>	Datum <u>08.06.2022</u>
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>08.06.2022</u>
Republika e Kosovës	



Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, nenit 5 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.06.2022, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-1736-B/22, për zyrtarin e lartë publikë znj. Arta Shehu-Zaimi, anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të mundshëm interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë znj. Arta Shehu-Zaimi, anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit sipas raportimit (nga jashtë) e ka hapur rastin për situatë të mundshme të konfliktit të interesit, sipas të cilit znj. Shehu-Zaimi duke qenë zyrtar i lartë publik, njëkohësisht mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat, si dhe atë të anëtares së bordit drejtues të një organizate joqeveritare.

Për t'i vërtetuar pretendimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare, është konstatuar se znj. Shehu-Zaimi e mbante funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat, "JCoders" SH.P.K.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit përmes shkresë (AKK-DPKI-06-02/1993/22) e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.



Pas dërgimit të kësaj shkrese, Agjencia kundër Korrupsionit ka kontaktuar me znj. Shehu-Zaimi dhe e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”,

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-02/2659/22) me dokumentet përcjellëse (informatat e biznesit), në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat.

Me veprimet e ndërmarra nga znj. Shehu-Zaimi, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ndërsa, lidhur me pretendimin se znj. Shehu-Zaimi si anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, njëkohësisht është edhe anëtare e Bordit Drejtues në organizatën joqeveritare “Germin”, e njëjta ka deklaruar se angazhimin e tillë e bënë në rolin e këshillueses dhe se për një gjë të tillë nuk kompensohet. Këtë e ka konfirmuar edhe me shkrim përmes përfaqësuesit të OJQ “Germin” (DPKI-06-02/2658/22).

Angazhimi i tillë nuk bie ndesh me Ligjin për Parandalimin Konfliktit të Interesit, kjo pasi që në nenin 14, paragrafi 2, është përcaktuar se:

“1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblyeri me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.”

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

